



BALLINA

LAJME ▾

VIDEO

BOTA

SPORT ▾

OPINION ▾

SHOWBIZ ▾

LIFESTYLE ▾

AUTO & TEK ▾

FUN ▾

ENGLISH ▾

E konfirmuar nga Policia e Kosovës: Një i plagosur nga gjuajtja me armë zjarri te “Kafet e Vogla”



LAJME

23/06/2023 22:59



Një person ka mbetur i plagosur nga gjuajtja me armë zjarri në pjesën e kryeqytetit që njihet si te “Kafet e Vogla”.

Këtë e konfirmoi edhe Policia e Kosovës përmes raportit, ku shpalosi detaje më të hollësishme, përcjell **lajmi.net**.

Tutje, bëhet e ditur se po zhvillohen veprime hetimore për t’i identifikuar të dyshuarit e implikuar në rast.

“Sot rreth orës 21:30, është raportuar për gjuajtje me armë zjarri të ndodhur në rrugën “Fehmi Agani” në Prishtinë. Policia menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes dhe nga informacionet e para është konfirmuar se një person është plagosur.

I njëjti është dërguar në QKUK për trajtimin e nevojshëm mjekësor. Ndërlidhur me rastin është gjetur edhe një armë zjarri ndërkohë që policia po vijon punën me veprime të ekzaminimit të vendngjarjes si dhe me veprime të tjera operativo-hetimore me qëllim identifikimin dhe lokalizimin e të dyshuarve të implikuar në rast”, thuhet ndër tjerash.

Artikuj të ngjashëm



June 24, 2023

Ekspertët dhe opozita alamarmojnë për tkurrje të punësimit, pushteti e mohon...



June 24, 2023

Ambasada e ShBA-së publikon një video: Sanksionet e kanë zvogëluar aftësinë...



June 24, 2023

Konspiracionisti kosovar: Skënderbeu ka luftuar në emër të Krishtit, kundër myslimanëve...



June 24, 2023

Vrasje në tentativë në Prishtinë



June 24, 2023

Raportohet se janë bastisur zyrat e Wagnerit në Shën Petersburg



June 24, 2023

Policia e Kosovës thërret konferencë të jashtëzakonshme për medie në Mitrovicë...

LAJME TË FUNDIT



Ekspertët dhe opozita alamarmojnë për tkurrje të punësimit,...



Fenerbahçe futet në garë për Milot Rashicën



Konspiracionisti kosovar: Skënderbeu ka luftuar në emër të...



”Bën muzikë “au iu”, Elvana Gjata në podcasin...

lajmi.net

info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

